



Nr. 06 prot
Dt. 04/01/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 5, datë 12/01/2022

“PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI NË LEJEN ME NR.SERIE 000140, MIRATUAR ME VENDIM NR. 12, DATË 23.04.2021 “PËR MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJIE SHOQËRISË HEC VILIQ 1&2 SH.P.K”, TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË.

Bazuar në pikën 2, neni 50, të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr. 550, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimeve ujore, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", si dhe në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin Bunë

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e afatit të vlefshmërisë në Lejen "Për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor" me nr. serial 000140, miratuar me Vendimin nr. 12, datë 23.04.2021, të Këshillit të Basenit Ujqor Drin-Bunë, nga "23.04.2021 - 22.04.2026" bëhet "Në përputhje me afatet e koncesionit".

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

